



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

5256
Nr. _____ prot.

Roskovec, më 10.07.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë 10.07.2026

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 71,
DATË 24.12.2025 “PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT PËRFUNDIMTAR TË PBA
2026-2028 DHE BUXHETIT TË VITIT 2026”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1 nënpika 1.1 shkronja “b”, nenit 54 shkronja “dh” të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, si dhe shkresës të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Nr. 652, datë 16.06.2026, protokolluar në Bashkinë Roskovec me Nr. 4530, datë 17.06.2026,

JU PARAQESIM PËR DISKUTIM E MIRATIM:

1. Ndryshimin e pikës 4 të Vendimit të Këshillit Bashkiak Roskovec Nr. 71, datë 24.12.2025 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të vitit 2026”, si më poshtë vijon:
 - Numri maksimal i punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive administrative dhe institucionit buxhetor në varësi të bashkisë për vitin 2026 nga **400 (katërqind)** punonjës të përhershëm bëhet **405 (katërqind e pesë)** punonjës të përhershëm.
Konkretisht shtohen në organikën e njësisë shpenzuese “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike” **5 (pesë)** punonjës të përhershëm dhe numri maksimal i punonjësve për njësinë shpenzuese “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike” ndryshon nga **208 (dyqind e tetë)** bëhet **213 (dyqind e trembëdhjetë)** punonjës të përhershëm.
2. Fondi të përballohet nga fondi për pagat dhe sigurimet shoqërore të miratuar për vitin 2026.
3. Pas miratimit të këtij projekt-vendimi ngarkohet për zbatim Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit, si dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

Konceptoi: O.Goga

V.Zeqo

Konfirmoi: D.Hoxha

KRYETARI
Majlinda Buçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

Nr. 5256/1 prot.

Roskovec, më 10.07.2026

Lënda: Relacion për projekt-vendimin: “Për miratimin e ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 71, datë 24.12.2025 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të vitit 2026”.

KËSHILLIT BASHKIAK

Roskovec

Të nderuar anëtar/e!

Në dhjetor të vitit 2025 me Vendimin e Këshillit Bashkiak Roskovec Nr. 71, datë 24.12.2025 është miratuar dokumenti përfundimtar i PBA 2026-2028 dhe buxhetit të vitit 2026, ku në pikën 4 të këtij vendimi është miratuar numri maksimal i punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe njësisve administrative dhe institucionit buxhetor në varësi të bashkisë për vitin 2026, i ndarë për njësinë shpenzuese “Bashkia Roskovec”, njësinë shpenzuese “Ndërmarrja Shërbimeve Publike” dhe për Gjendjen Civile.

Aktualisht në Bashkinë Roskovec është administruar shkresa e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Nr. 652, datë 16.06.2026 protokolluar në Bashkinë Roskovec me Nr. 4530, datë 17.06.2026, nëpërmjet të cilës është paraqitur kërkesë për shtesë punonjësish në organigramën e Ndërmarrjes.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e madhe që ka sistemi i ujitje-kullimit për zhvillimin e aktivitetit bujqësor në territorin e Bashkisë Roskovec, si dhe investimet e kryera për rehabilitimin dhe përmirësimin e stacioneve të pompimit dhe infrastrukturës ujitëse e kulluese, paraqitet nevoja për krijimin e një strukture të posaçme organizative që të garantojë administrimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e tyre në mënyrë të vazhdueshme dhe efikase.

Aktualisht, stacionet e pompimit dhe rrjeti i ujitje-kullimit përfaqësojnë një aset të rëndësishëm publik, i cili kërkon mbikëqyrje të specializuar, mirëmbajtje periodike dhe personel të dedikuar për funksionimin e tij. Mungesa e një strukture të veçantë dhe e personelit të mjaftueshëm rrezikon efikasitetin e investimeve të kryera dhe mund të sjellë probleme në ofrimin e shërbimit për fermerët dhe përdoruesit e sistemit.

Krijimi i kësaj strukture do të mundësojë ruajtjen dhe shfrytëzimin efektiv të investimeve të realizuara, rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj fermerëve dhe garantimin e funksionimit të qëndrueshëm të infrastrukturës së ujitje-kullimit në territorin e Bashkisë Roskovec.

Për funksionimin normal të kësaj strukture, do të parashikohen punonjës në këto pozicione pune:

- Specialist për administrimin dhe monitorimin teknik të sistemit;
- Operatorë të Stacioneve të Pompimit (sipas numrit të stacioneve në administrim);
- 1 Elektricitist/Mekanik për mirëmbajtjen e agregateve dhe pajisjeve teknologjike.

Për sa më sipër është e nevojshme të bëhen shtesë 5 (pesë) punonjës të përhershëm në organikën e njësisë shpenzuese “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike”.

Në përfundim, në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1 nënpika 1.1 shkronja “b”, nenit 54 shkronja “dh” të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, si dhe shkresës Nr. 652, datë 16.06.2026 protokolluar në Bashkinë Roskovec me Nr. 4530, datë 17.06.2026, propozojmë:

1. Ndryshimin e pikës 4 të Vendimit të Këshillit Bashkiak Roskovec Nr. 71, datë 24.12.2025 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të vitit 2026”, si më poshtë vijon:
 - Numri maksimal i punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive administrative dhe institucionit buxhetor në varësi të bashkisë për vitin 2026 nga **400 (katërqind)** punonjës të përhershëm bëhet **405 (katërqind e pesë)** punonjës të përhershëm.
 - Konkretisht shtohen në organikën e njësisë shpenzuese “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike” **5 (pesë)** punonjës të përhershëm dhe numri maksimal i punonjësve për njësinë shpenzuese “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike” ndryshon nga **208 (dyqind e tetë)** bëhet **213 (dyqind e trembëdhjetë)** punonjës të përhershëm.
2. Fondi të përballohet nga fondi për pagat dhe sigurimet shoqërore të miratuar për vitin 2026.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin,

Konceptoi: O.Goga

V.Zeqo

Konfirmoi: D.Hoxha

